

BEQIR META**PAKICA MALAZEZE, ROMËT DHE HEBRENJTË
GJATË VITEVE 1925-1939****Pakica malazeze e Vrakës***Shkollat serbe në Shkodër dhe Vrakë*

Në vitet e para të regjimit të A. Zogut u ruajt influenca e Jugosllavisë në popullsinë ortodokse të Shkodrës. Vijonin të funksiononin dy shkolla private serbe që sponsorizoheshin në mënyrë të fshehtë nga qeveria jugosllave. Njëra prej tyre ishte në Shkodër. Megjithëse ortodoksët e Shkodrës ishin shqiptarë nga raca, gjuha dhe zakonet, disa prej tyre i dërgonin fëmijët në këtë shkollë, e cila punonte intensivisht që të përhapte gjuhën serbe tek ortodoksët shqiptarë të Shkodrës për t'u ndryshuar kombësinë e tyre. Për më tepër, kjo shkollë nuk kishte plotësuar formalitetet e duhura ligjore për funksionimin e saj. Prandaj, në prill të vitit 1926, prefektura e Shkodrës propozoi mbylljen e saj¹.

Ndërsa shkolla tjetër private serbe që funksiononte në fshatin Vrakë nuk u mësonte fare nxënësve gjuhën shqipe, gjë që binte në kundërshtim me dispozitat e traktateve të minoriteteve. Prefektura e Shkodrës sugjeroi që edhe ajo të mbyllej dhe të hapej një shkollë tjetër shtetërore në gjuhën sllave².

Në vitin 1927 shkolla private ortodokse e Shkodrës kishte katër klasa me 86 nxënës (54 djem dhe 32 vajza). Funksiononte gjithashtu edhe shkolla private e Vrakës edhe kjo me katër klasë me 70 nxënës. Ajo vijonte të financohej nga shteti jugosllav, në kundërshtim të hapur me dispozitat e traktateve për mbrojtjen e minoriteteve³.

Edhe në vitin 1928 në shkollat ortodokse serbe të Vrakës e të Shkodrës vijonin të punonin mësues me nënshtetësi serbe të cilët

¹ Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH), Fondi (më tej: F.) MPB, viti (më tej: V.) 1926, dosja (më tej: D.) 19, fl. 9, 11. Prefektura e Shkodrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 22 mars dhe 3 prill 1926.

² Po aty, fl. 7. Prefektura e Shkodrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 17 shkurt 1926.

³ Po aty, F. Ministria e Arsimit (MA), V. 1927, D. 61, fl. 93-94.

vepronin në kundërshtim me legjislacionin shqiptar⁴. Në fakt, kishte edhe një paqartësi në Ministrinë e Arsimit mbi statusin që i takonte shkollës serbe të Shkodrës dhe mbi të drejtat e komunitetit ortodoks shqiptar të Shkodrës për të mbajtur një shkollë të tillë⁵.

Ndërkohë, konsullata jugosllave vijonte t'u jepte bursa shumë djemve ortodoksë të këtij qyteti për të studiuar në shkollat jugosllave⁶. Nga ana tjetër, autoritetet jugosllave ndëshkonin me rreptësi ata nxënës shqiptarë nga trojet shqiptare nën Jugosllavi që tentonin të vinin në Shqipëri për të kryer shkollat shqipe.

Qeveria shqiptare mori masa për të ndaluar shkollimin ilegal të djemve ortodoksë shqiptarë në Jugosllavi. Studentëve që frekuentonin Seminarin e Manastirit iu refuzua dhënia e vizës. Ky qëndrim mbështetej në vendimin e Këshillit të Ministrave, i cili ndalonte frekuentimin e shkollave të mesme të huaja pa lejen e Ministrisë së Arsimit⁷. Këto masa ishin në përputhje me legjislacionin ndërkombëtar për minoritetet. Ato u morën pas konsolidimit të pozitave të regjimit brenda vendit dhe përmirësimit të tyre në aspektin ndërkombëtar. Më parë, administrata shqiptare i kishte toleruar këto shkelje pasi ajo i kishte gjykuar pozitën e saj më të dobëta dhe, për këtë arsye, ishte përpjekur të shmange çdo komplikacion brenda dhe jashtë vendit.

Çështja e minoriteteve në Shqipëri tërhoqi edhe vëmendjen e studiuesve e publicistëve të kohës. Ata veçonin faktin se, megjithëse minoritetet greke, malazeze dhe bullgaro-maqedone ishin shumë të pakët në numër, ato ishin shndërruar në instrumente propagandistike nga Greqia e Jugosllavia.⁸ Gjithashtu ata theksonin se situata e këtyre minoriteteve në Shqipëri ishte krejt e ndryshme nga gjendja e minoriteteve në vendet e tjera. Ata evidentonin se edhe në Shqipëri ekzistonte fenomeni i asimilimit të minoriteteve nga shumica por ky fenomen po zhvillohej “në ato kufij që lejonte mbrojtjen e shtetit shqiptar

⁴ *Po aty*, F. MPB, V. 1928, D. 542, fl. 1. Ministria e Arsimit drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 14 shkurt 1928.

⁵ *Po aty*, F. MPB, V. 1928, D. 218, fl. 12. Ministria e Arsimit drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 22 gusht 1928.

⁶ *Po aty*, fl. 1-2. Prefektura e Shkodrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 10 gusht 1928.

⁷ *Po aty*, F. MPB, V. 1928, D. 218, fl.15. Ministrisë së Punëve të Brendshme drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, 9 tetor 1928.

⁸ Enrico Aci Monfosca, *Le Minoranze Nazionali Contemplate dagli Atti Internazionali*, volume secondo, Paesi Danubiani, Balcanici e Turchia, Firenze: 1929, f. 205-206.

dhe ruajtjen e marrëdhënieve të mira me shtetet e afërt si dhe me synimin për të evituar reprezaljet kundër minoriteteve të forta shqiptare në Greqi dhe veçanërisht në Jugosllavi⁹.

Ministria e Arsimit u përpoq të disiplinonte aktivitetin e dy shkollave ortodokse të Vrakës e të Shkodrës. Në shkollën e Shkodrës ajo u dha leje që të jepnin mësim mësuesve Harallamb Andriq, Angjelina Andriq dhe B. Dezenka Gjergjeviç meqë ata kishin dokumente të rregullta. Mësimet në këto shkolla do të jepeshin në përputhje me programet e shkollave filllore shtetërore dhe në gjuhën shqipe, ndërsa, gjuha sllave do të jepej si gjuhë e huaj¹⁰. Mirëpo këto urdhëresa nuk u zbatuan. Shkolla e Shkodrës vijoi punën si më përpara dhe ruajti karakterin e një shkolle jugosllave. Për këtë arsye, Ministria e Arsimit urdhëroi largimin e atyre mësuesve që nuk dinin gjuhën shqipe dhe që nuk kishin nënshtetësinë shqiptare. Autoritetet shqiptare kërkuan që librat dhe regjistrat e kësaj shkolle duhej të ishin zyrtare. Në rast se nuk do të plotësoheshin këto kërkesa, shkolla do të mbyllej¹¹. Qeveria e udhëzoi prefekturën e Shkodrës t'i kërkonte kësaj shkolle të respektonte programin që ishte në zbatim në të gjithë shkollat e vendit. Arsyeja ishte se popullsia ortodokse e Shkodrës nuk ishte "minoritet racor ose kombëtar". Ky komunitet ishte i përbërë nga shqiptarë të ardhur nga vise të ndryshme thjesht shqiptare, të cilët flisnin shqip në shtëpitë e tyre dhe marrëdhëniet tregtare etj., i zhvillonin në këtë gjuhë. Ndërsa, gjuhën sllave ata mund ta mësonin vetëm si gjuhë të dytë, disa orë në javë, duke përdorur tekste shkollore që do të aprovohejshin nga Ministria e Arsimit¹².

Një qëndrim tjetër mbahej ndaj shkollës së Vrakës. Meqë banorët e atij fshati, më së shumti, flisnin gjuhën sllave, mësimet në atë shkollë do të jepeshin në gjuhën sllave dhe shqipja do të mësohej një orë në ditë¹³. Ky ishte një qëndrim korrekt dhe në përputhje me traktatet e Lidhjes së Kombeve për mbrojtjen e minoriteteve.

Megjithëkëtë qeveria jugosllave vijonte t'i shkelte këto traktate, duke ndërhyrë drejtpërdrejtë në çështjen shkollore. Prefekti i Shkodrës, Kol

⁹ *Po aty*.

¹⁰ *AQSH*, F. MA, V. 1929, D. 91, fl. 3. Ministria e Punëve të Jashtme drejtuar prefekturës së Shkodrës, 17 tetor 1929.

¹¹ *Po aty*, fl. 18. Ministria e Arsimit drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 26 nëntor 1929.

¹² *Po aty*, fl. 31. Ministria e Arsimit drejtuar prefekturës së Shkodrës, 2 nëntor 1929.

¹³ *Po aty*, fl. 34. Ministria e Arsimit drejtuar prefekturës së Shkodrës, 6 nëntor 1929.

Rodhe informonte se këto dy shkolla po financoheshin edhe nga qeveria jugosllave për qëllime propagandistike. Ai theksonte se banorët ortodoksë të Shkodrës, përgjithësisht, ishin vllahë të ardhur nga Durrësi, Kavaja, Berati etj. Mësuesit që jepnin mësim këtu, jo vetëm nuk ishin nënshtetas shqiptarë, por kishin edhe ndjenja sllave. Rodhe kërkonte largimin e tyre dhe zëvendësimin me mësues nga Korça¹⁴.

Në vitin 1929 vijuan të funksiononin të dy shkollat serbe. Në këto shkolla punonin 10 mësues, dy prej të cilëve ishin me origjinë shqiptare dhe tetë me origjinë serbe. Numri i gjithë nxënësve në këto shkolla ishte 120 dhe shteti shqiptar shpenzonte 4980 fr. ari në vit për mbajtjen e këtyre shkollave¹⁵.

Qeveria shqiptare ishte e vendosur që, ashtu si gjithë shkollat e tjera minoritare, edhe shkolla e Vrakës të funksiononte në përputhje me legjislacionin shqiptar, e veçanërisht të respektohej artikulli 207 i Statutit Themelor të Mbretërisë Shqiptare. Në rast të kundërt, ajo do të mbyllej¹⁶.

Në fillim të vitit 1930, qeveria shqiptare u mundua të zgjidhte me mirëkuptim çështjen e funksionimit ligjor të shkollës ortodokse të Shkodrës. Ministri i Jashtëm i Shqipërisë i kërkoi të Ngarkuarit me Punë të Jugosllavisë të ndërhynte pranë drejtorit të kësaj shkolle që ai të zbatonte rregullat shtetërore. Përfaqësuesi jugosllav u zotua se gjendja e kësaj shkolle do të ndryshonte. Mirëpo, disa ditë më vonë, ai e lajmëroi MPJ se drejtori i shkollës pretendonte që i kishte zbatuar të gjitha kërkesat e parashikuara nga Ministria e Arsimit¹⁷. Në këto rrethana, Ministria e Arsimit urdhëroi mbylljen e shkollës ortodokse të Shkodrës, meqenëse, ajo kishte kundërshtuar vazhdimisht zbatimin e programit mësimor të miratuar prej saj, mësimet i kishte zhvilluar të gjitha në gjuhën serbe pa dhënë asnjë orë mësimi në gjuhën shqipe, mësuesit e saj nuk e dinin gjuhën shqipe dhe nuk ishin nënshtetas shqiptarë, ndërsa librat dhe regjistrat që ajo përdorte nuk ishin miratuar nga Ministria e

¹⁴ *Po aty*, fl. 52-53. Prefektura e Shkodrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme.

¹⁵ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AMPJ*), V. 1929, D. 797, fl. 7. Pasqyrë përmbledhëse e shkollave të minoriteteve etnike në Shqipëri.

¹⁶ *Po aty*, V. 1929, D. 796. Përgjigje e Ministrisë së Arsimit dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme për shkollat minoritare, 10 shtator 1929.

¹⁷ *Po aty*, V. 1930, D. 288, fl. 1. Ministria e Punëve të Jashtme drejtuar Ministrisë së Arsimit, 3 janar 1930.

Arsimit. Kjo ministri, theksonte se e kishte lejuar veprimtarinë e kësaj shkolle përkohësisht me qëllim që të përgatitej për plotësimin e kërkesave të lartpërmendura, por ajo nuk i plotësoi kurrë këto kushte¹⁸.

Nga një kontroll i kryer në shkollën ortodokse të Shkodrës, rezultoi se drejtori i saj nuk e kishte vënë tabelën e shkollës në gjuhën shqipe. Madje, ai refuzoi ta vendoste atë edhe kur këtë gjë ia kërkuan autoritetet vendore. Në muret e shkollës ishin varur shumë portrete nacionalistësh serbë. Për këtë arsye, prefektura e Shkodrës i hoqi lejen e ushtrimit të profesionit drejtorit të kësaj shkolle Harallamb Andriqit dhe e zëvendësoi me Luigj Sheldinë, pezulloi mësuesit Vuk Stajkoviç, Milica Stajkoviç e Angelina Andriq sepse ato nuk e dinin gjuhën shqipe dhe nuk kishin dhënë asnjë orë mësimi shqip¹⁹. Këto masa u pritën mirë nga opinioni shkodran²⁰. Mirëpo tre-katër ditë më vonë, Ministria e Arsimit urdhëroi që t'u jepej leja e ushtrimit të profesionit të gjithë mësuesve të lartpërmendur. Prefektura e Shkodrës e shfrytëzoi këtë rast për të zëvendësuar drejtorin e mëparshëm me një drejtor të ri²¹.

Në vitin 1930-1931 vijonin të funksiononin 2 shkolla serbe me 11 mësues dhe 142 nxënës. Për mbajtjen e tyre shteti shqiptar paguante 6300 fr. ari në vit²².

Përpyjekjet për krijimin e një shoqërie sllave në Shkodër

Në qytetin e Shkodrës në vitet 1925-1926 vepronte shoqëria “Obiliq” e cila, nëpërmjet teatrit, po përpiqej të përhapte ndjenjat dhe gjuhën serbe midis ortodoksëve shqiptarë. Populli i Shkodrës e shihte me pakënaqësi aktivitetin e kësaj shoqërie, e cila përpiqej të ndryshonte identitetin kombëtar të fëmijëve shqiptarë²³. Por, në këtë fazë të parë, regjimi i ri

¹⁸ *Po aty*, fl. 5. Ministria e Arsimit drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, 13 janar 1930.

¹⁹ *AQSH*, F. MPB, V. 1930, D. 304, fl. 2. Prefektura Shkodër drejtuar Inspektorisë së Arsimit Shkodër, 2 janar 1930.

²⁰ *Po aty*, fl. 13. Prefektura e Shkodrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 7 janar 1930.

²¹ *Po aty*, fl. 16. Prefektura e Shkodrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 9 janar 1930.

²² *AQSH*, F. MA, V. 1931, D. 31, fl. 1. Pasqyrë mbi shkollat minoritare në Shqipëri, 1930-1931.

²³ *Po aty*, F. MPB, V. 1926, D. 19, fl. 12. Prefektura e Shkodrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 7 gusht 1926.

ishite shumë i kujdesshëm dhe donte të shmangte incidentet e keqkuptimet me Beogradin. Prandaj, autoritetet vendore e toleruan përkohësisht në heshtje aktivitetin e kësaj shoqërie.

Në verën e vitit 1928, shoqëria “Obiliq” po përpiquej të shfaqte disa pjesë teatrale në gjuhën serbe. Por, tashmë, ndryshe nga dy vite më parë, përveç popullsisë, reagues edhe autoritetet shtetërore. Prefektura nuk lejoi zhvillimin e këtyre aktiviteteve, pasi kjo shoqëri nuk ishte njohur zyrtarisht nga shteti shqiptar²⁴.

Ministria e Brendshme urdhëroi që kjo shoqëri të mbyllej në bazë të art. 6 të desturit (tertibi thanixhild) të Ligjit Otoman, i cili ishte ende në fuqi²⁵. Shoqëria u mbyll përkohësisht. Kryetari, këshilltarët dhe anëtarët e saj i paraqitën prefekturës një deklaratë patriotike proshqiptare, në të cilën kërkonin faljen e këtij gabimi²⁶. Më tej, Ministria e Brendshme u tërhoq nga urdhri i parë. Ajo udhëzoi prefekturën e Shkodrës që të porosiste kryetarin e kësaj shoqërie të kërkonte leje të rregullt nga qeveria dhe, në rast se shoqëria fillonte sërish aktivitetin e saj, prefektura duhej të “mbyllte sytë” deri në një urdhër të dytë²⁷. Ky ndryshim në qëndrimin e MPB, synonte të shmangte ndonjë konflikt të padëshiruar me Jugosllavinë në këto momente delikate, kur Asambleja Kushtetuese do të shpallte monarkinë. Ministria e Brendshme porosiste: “Është nevojë e domosdoshme që të mos kemi as më të voglin konflikt”. Ajo e siguronte prefekturën se kryetarin e shoqërisë “Obiliq” nuk do t’i akordohej leja e kërkuar, por ishte e nevojshme që gjatë këtyre ditëve të mos kishte konflikte²⁸.

Pas shpalljes së Monarkisë, shoqëria u mbyll. Legata jugosllave në Tiranë nuk ndenji duarkryq por protestoi për mbylljen e shoqërisë “Obiliq”. Në vitin 1929, nxënësit e shkollës serbe u përpoqën ta rithemelonin këtë shoqëri. Kur ishte mbyllur kjo shoqëri, qeveria nuk i kishte dënuar themeluesit e saj. Kjo e shtoi guximin e nxënësve të cilët,

²⁴ *Po aty*, F. MPB, V. 1928, D. 218, fl. 1-2. Prefektura e Shkodrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 10 gusht 1928.

²⁵ *Po aty*, fl. 3. Ministria e Punëve të Brendshme drejtuar prefekturës Shkodër, 13 korrik 1928.

²⁶ *Po aty*, fl. 6. Prefektura e Shkodrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 16 gusht 1928.

²⁷ *Po aty*, fl. 18. MPB drejtuar prefekturës Shkodër.

²⁸ *Po aty*, fl. 7, 11. Udhëzime të Ministrisë së Punëve të Brendshme për prefekturën e Shkodrës, 19 dhe 22 gusht 1928.

të nxitur dhe nga konsulli jugosllav, patën kurajën të kërkonin sërish hapjen e kësaj shoqërie. Sipas statutit, qëllimi i shoqërisë ishte sportiv. Mirëpo nga organizimi i brendshëm, dukej qartë së kjo ishte një organizatë e fshehtë. Për këtë arsye, organet e policisë u kërkuan iniciatorëve të ndryshonin emrin e shoqërisë, duke e zëvendësuar me një emër shqiptar dhe të ndryshonin disa nene të paqarta e të dyshimta të statutit²⁹.

Prefektura e Shkodrës nënvizonte se djemtë vrakaçorë dhe gjithë agjentët jugosllavë po punonin lirisht pasi, deri në këtë kohë, jo vetëm që nuk ishte marrë ndonjë masë kundër propagandistëve jugosllavë, por ata ishin përkrahur me vepra prej qeverisë shqiptare për rihapjen e shkollës së tyre ashtu dhe për çështjen kishtarë³⁰. Ajo propozonte marrjen e masave të forta e të shpejta ligjore ose të ndërmerreshin veprime të drejtpërdrejta e të tërthorta administrative për internimin e nismëtarëve të shoqërisë, në mënyrë që të ndalohej një herë e mirë kjo veprimtari dhe populli ortodoks i Shkodrës që i ndiqte në fshehtësi këta, të kuptonte se duhej t'u bindej urdhrave të qeverisë³¹.

Në vitet që pasuan në dokumentacionin arkivor shqiptar nuk ndeshen të dhëna për ekzistencën e kësaj shoqërie. Mesa duket ajo e pushoi aktivitetin e saj në vitin 1929.

Çështja e Kishës Ortodokse Serbe

Shteti shqiptar bëri përpjekje për të kufizuar ndërhyrjen e kishës serbe në çështjet e Kishës Autoqefale Shqiptare duke përdorur si pikëmbështetje minoritetin e vogël sllav të Vrakës dhe ortodoksët në prefekturat e Peshkopisë dhe të Shkodrës. Në vitin 1928, peshkopi i Ohrit kishte emëruar një famullitar për ortodoksët e Peshkopisë dhe të Steblevës, por ai nuk u lejua të ushtronte aktivitetin e tij. Autoritetet lokale i kërkuan që të merrte leje nga Kryesia e Kishës Autoqefale Shqiptare³². Autoritetet shtetërore i kërkuan Kryesisë së KOASH, të emëronte një prift shqiptar në këtë vend vakant, me qëllim që të mos u

²⁹ *Po aty*, F. MPB, V. 1929, D. 18, fl. 12-13. Prefektura e Shkodrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 29 janar 1929.

³⁰ *Po aty*.

³¹ *Po aty*.

³² *AQSH*, F. MPB, V. 1928, D. 39, fl. 152. Prefektura Dibër drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 20 prill 1928.

krijohej ndonjë shteg jugosllavëve për të ngritur pretendime minoritetesh³³. Megjithatë, çështja nuk u zgjidh menjëherë. Golloborda dhe Zerqani nuk kishin një prift shqiptar dhe ceremonitë fetare po i kryente një prift jugosllav, i cili vinte herë pas here nga Jugosllavia³⁴.

Shqipëria ishte shembull tipik se si, në një shtet të vogël e të dobët, pakicat e çdo lloji, duke pasur mbështetje nga shtetet e fuqishme fqinje, ishin bërë një faktor i rëndësishëm në jetën e atij shteti, madje me peshë më të madhe në raport me numrin e tyre.

Kështu ndodhi edhe me banorët sllavofonë të Vrakës, të cilët u përdorën nga Beogradi për të fituar pozita të rëndësishme dominuese në Kishën Ortodokse të Shqipërisë. Në prag të zhvillimit të Kongresit Ortodoks të vitit 1929, përfaqësuesi jugosllav në Shqipëri ushtroi një presion të fortë ndaj Visarion Xhuvanit, duke përdorur kërcënime ndaj tij dhe KOASH, me qëllim që peshkopi serb Viktori të caktohej në krye të Kishës Ortodokse të Shkodrës. Por, kryepeshkopi Visarion e refuzoi kategorikisht këtë kërkesë³⁵. Legata jugosllave ishte informuar se Kongresi do të suprimonte gjithë statuskuonë kishtarë të Shkodrës. Gjatë debatit, përfaqësuesi i legatës jugosllave u duk se u bind nga argumentet që paraqiti kryetari i Sinodit të KOASH por hezitonte t'i raportonte këto argumente në Beograd³⁶.

Në prag të Kongresit, peshkopi serb Viktori bëri një vizitë në Korçë. Ministria e Brendshme e përcolli me shqetësim këtë ngjarje. Ajo porositi kryetarin e Sinodit që të paralajmërohej Viktori se nuk mund të lejohej të merrte pjesë në Kongres, pasi ai nuk ishte delegat i zgjedhur nga popullsia ortodokse e Shkodrës. Për këtë arsye, ai nuk duhej të qëndronte në Korçë kur të zhvillohej Kongresi, pasi qëndrimi i izoluar në këtë kohë atje do të dëmtonte autoritetin e tij fetar³⁷.

Nga ana tjetër, prefektura e Shkodrës u përpoq të bindte Viktorin që të caktonte si delegat në Kongres, Risto Siliqin dhe Vasil Palajn, por ai nuk pranoi, duke u justifikuar se i pari nuk ishte dukur kurrë në kishë dhe populli ortodoks e konsideronte si katolik e kishte antipati për të, ndërsa

³³ *Po aty*, fl. 156. Nënprefektura e Zerqanit drejtuar prefekturës Dibër, 30 tetor 1928.

³⁴ *Po aty*, fl. 158. MPB drejtuar prefekturës Korçë, 10 nëntor 1928.

³⁵ *Po aty*, F. MPB, V. 1929, D. 19/A, fl. 223. Prefektura e Elbasanit drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 10 qershor 1929.

³⁶ *Po aty*.

³⁷ *Po aty*, fl. 223. Prefektura e Elbasanit drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 10 qershor 1929.

të dytin, Vasil Palajn, nuk e njihte askush. Viktori u deklaroi autoriteteve vendore që qeveria nuk duhej të ushqente mosbesimin më të vogël tek delegatët që do të zgjidheshin, sepse ata do të thoshin “amen” për çdo bisedë e vendim që do të merrej në Kongres! Ai u ankua se Visarioni e kishte qortuar ashpër për vajtjen në Korçë por ky i ishte përgjigjur se kishte vajtur “si iniciator i kësaj çështje [KOASH] dhe si shqiptar”. Kleriku serb paralajmëroi se nervozizmi i Visarionit nuk do të kishte konsekuenca të mira, as për pjesëtarët e Sinodit, as tek kleri. Ai shtoi se interesi i KOASH dhe interesi politik kërkonte që ai, jo vetëm të shkonte në Korçë, porse ai duhej të ishte thirrur prej kryesisë së Sinodit, sepse kështu çështja e autoqefalisë së Kishës Ortodokse Shqiptare do të lidhej fort me Patrikanën Serbe, sidomos sepse “populli ortodoks i Shkodrës dhe delegatët e tij shohin se unë, si shpirtërisht ashtu dhe kombëtarisht, jam i bashkuar me ta”³⁸. Por, në të vërtetë Viktori kishte përgatitur një goditje pas shpine të KOASH.

Duke përfitur nga vështirësitë që po ndeshte shteti shqiptar në organizimin e KOASH, disa përfaqësues të këtij komuniteti, Velisha Popoviq, Naum Plevenshi e Mitro Llazaroviq u përpoqën t’i paraqisnin një memorandum Kongresit të KOASH të vitit 1929, i cili përmbante këto kërkesa: 1 - Peshkopi serb Viktori duhej të merrte pjesë në Kongres, në bazë të së drejtës dhe detyrës. Gjithashtu, ai duhej të zgjidhej anëtar i Sinodit sepse “prezenca e tij i kishte dhënë një garanci organizimit të KOASH”. Ata protestonin për mosthirrjen e tij në Kongres dhe për moszgjedhjen në Senat; 2 - kërkonin rikthimin e *statusquo*-së kishtarë të periudhës para pavarësisë së Shqipërisë, ku të kishte një peshkop sllav për Shkodrën, katundet e saj dhe për Gollobordën. Gjithashtu, ata kërkonin që mesha në këto fshatra të bëhej në gjuhën sllave, të ruheshin shkollat sllave dhe festat fetare të zhvilloheshin sipas kalendarit të vjetër³⁹.

Nga hetimet që bëri prefektura e Korçës, rezultoi se delegatët ortodoksë shqiptarë të Shkodrës e kishin miratuar këtë memorandum, jo me ndonjë qëllim të keq, por duke u nisur nga premtimet që u kishte bërë imzot Visarioni se të drejtat e tyre kishtarë e gjuhësore do të mbeteshin ashtu siç kishin qenë më parë. Prandaj, ata ia kishin dorëzuar atij këtë

³⁸ *Po aty*, F. MPB, V. 1929, D. 119/1, fl. 123-124. Prefektura e Shkodrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 24 qershor 1929.

³⁹ *Po aty*, F. MPB, V. 1929, D. 119/2A, fl. 278-279. Prefektura e Korçës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 22 qershor 1929.

letër, “me qëllim që të kujtonin dëshirën e ortodoksëve të Shkodrës dhe premtimin që u kishte dhënë Visarioni atyre”⁴⁰.

Ministria e Brendshme ndërhyri për të bllokuar paraqitjen e këtij memorandumi në Kongres. Madje, ajo porositi që ky dokument as të mos zihej më me gojë nga asnjëri⁴¹. Gjithashtu u dhanë porosi që të këshilloheshin delegatët e Shkodrës se këto kërkesa nuk mund të përkrasheshin kurrë nga shumica e Kongresit dhe nuk do të kishin asnjë dobi, përveçse do t’i jepnin të kuptonte qeverisë se ata po punonin në dobi të interesave të të tjerëve dhe në dëm të interesave kombëtare shqiptare. Ministria e Brendshme porositi që të këshillohej dhe Visarion Xhuvani, “se ishte nevojë e domosdoshme që të rrallonte kontaktet me jugosllavët, madje t’i ndërpriste fare ato, pasi, në rast të kundërt, ajo ministri do të fillonte të dyshonte në sjelljet e tij”⁴².

Peshkop Viktori u bind për të mos marrë pjesë në Kongres, pasi mori nga Visarioni një shumë të majme prej 1600 fr. ari, dhe, kur u pranua kërkesa e tij që të merrte pjesë në tedeumin që u mbajt në kishën e Shën Gjergjit⁴³. Në ceremoninë e hapjes së Kongresit mori pjesë edhe konsulli jugosllav. Visarionin e takoi sekretari i legatës jugosllave, i cili theksoi se, ministri i Jashtëm jugosllav, Marinkoviç kërkonte nga KOASH që të lejonte pjesëmarrjen e Viktorit në Kongres, si provë të sinqeritetit të saj ndaj Jugosllavisë⁴⁴.

Ndonëse në Vrakë vijoi rezistenca ndaj KOASH, popullsia ortodokse e Shkodrës pas kongresit kishtar e ndryshoi momentalisht qëndrimin e saj. Në fund të gushtit të vitit 1929 në Shkodër arriti zëvendësmitropoliti, Josif, i cili u prit në një atmosferë entuziaste nga populli dhe kleri ortodoks i Shkodrës. Ai lexoi urdhrin e kryetarit të KOASH, Visarionit dhe mbajti një fjalim të gjatë në favor të Mbretit dhe Kishës Autoqefale Shqiptare, i cili u përshëndet nga brohoritje të pareshtura⁴⁵.

Presioni jugosllav vijoi edhe në drejtim të disa fshatrave ortodokse të krahinës së Dibrës. Në shkurt të vitit 1929, kryesia e KOASH dërgoi në

⁴⁰ *Po aty*, fl. 281. Prefektura e Korçës drejtuar MPB, 22 qershor 1929.

⁴¹ *Po aty*, fl. 280. MPB drejtuar prefekturës së Korçës, 22 qershor 1929.

⁴² *Po aty*.

⁴³ *Po aty*, fl. 242-243. Prefekti i Korçës, Hil Mosi, drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 17 qershor 1929.

⁴⁴ *Po aty*.

⁴⁵ *Po aty*, fl. 355-366. Prefektura e Shkodrës drejtuar MPB, 31 gusht 1929.

Peshkopi një prift shqiptar patriot⁴⁶. Me qëllim që t'u priste rrugën zhvillimit të meshave dhe të formaliteteve fetare që kryenin priftërinjtë jugosllavë tek popullsia ortodokse e Gollobordës, KOASH emëroi si prift në këtë krahinë, Anastas Davidhin. Ministria e Brendshme e konsideronte këtë çështje të rëndësishme, prandaj porositi autoritetet vendore të merrnin të gjitha masat për ta ndihmuar atë dhe popullsinë vendase, që të mos lejohej t'i kryente shërbesat fetare me priftërinj jugosllavë⁴⁷.

Ardhja e delegacionit jugosllav të kufirit në Shkodër nxiti një lëvizje më të madhe të të gjithë agjentëve të konsullit jugosllav dhe të disa vrakaçorëve, të cilët, duke u ushqyer nga ëndrrat sllavomadhe, e intensifikuan kundërshtimin ndaj KOASH dhe urdhrave të qeverisë shqiptare.

Gjatë muajve nëntor-dhjetor të vitit 1929, vijoi një ballafaqim i ashpër midis kryesisë së KOASH dhe agjentëve e priftërinjve serbë të Vrakës. Në fillim të nëntorit kryepeshkopi Visarion, pasi u informua se prifti i Vrakës, Velisha Popoviç kishte ngritur krye kundër KOASH, emëroi në vendin e tij famullitarin e Linit – Erazmin, i cili kishte njohur dhe respektuar autoqefalinë e Kishës Ortodokse Shqiptare. Visarioni, gjithashtu, urdhëroi zëvendësmitropolitin e Shkodrës, episkop Gjeninsin që ta ndëshkonte pop Velishen për këtë veprim, duke e ndaluar për 15 ditë nga çdo shërbim fetar dhe duke e transferuar në manastirin e Shën Gjonit në Elbasan. Në qoftë se pas këtij ndëshkimi ai do t'i bindej KOASH, do të transferohej në një vend tjetër, ku nuk mund të merrej me çështje politike⁴⁸.

Por, elementët serbë vijonin të rezistonin. Disa ditë më pas, në shtëpinë e priftit të Vrakës, Velisha Popoviçit u mbajt një mbledhje, e cila kishte qëllime politike dhe drejtohej kundër KOASH. Në këtë mbledhje ishte diskutuar mbi organizimin e qëndresës kundër Kishës Autoqefale Shqiptare dhe për mospranimin e gjuhës shqipe në shkollën e Vrakës. Sipas instruksioneve të konsullit jugosllav të Shkodrës, ishte krijuar një organizatë, së cilës ai i kishte premtuar përkrahje dhe të

⁴⁶ AQSH, F. MPB, V. 1929, D. 119/1, fl. 141. Ministria e Punëve të Brendshme drejtuar prefekturës Dibër, 27 shkurt 1929.

⁴⁷ Po aty, F. MPB, V. 1929, D. 119/A, fl. 270. Ministria e Punëve të Brendshme drejtuar nënprefekturës Zërëqan, 24 janar 1929.

⁴⁸ Po aty, F. MPB, V. 1929, D. 18, fl. 160. Prefektura e Korçës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 11 nëntor 1929.

holla⁴⁹. Autoritetet shqiptare morën masa dhe arrestuan pesë organizatorët e kësaj mbledhjeje.⁵⁰ Megjithëse prifti i Vrakës deklaroi hapur para autoriteteve të prefekturës së Shkodrës se nuk e njihte kishën autoqefale, ndaj tij nuk u mor asnjë masë ligjore⁵¹.

Prefektura e Shkodrës internoi në Kurvelesh për një vit 4 persona, ndërsa katër të tjerë u internuan për një afat gjashtë mujor, me akuzën për propagandë kundër regjimit dhe për lidhje e bashkëpunim me të arratisurit politikë. Ky dënim u zbatua pas vendimit të marrë nga Këshilli i Ministrave më 10 dhjetor 1929⁵². Disa ditë më vonë edhe Këshilli Kishtar i Shkodrës përjashtoi nga radhët e veta një prift me nënshtetësi serbe⁵³. Ministria e Brendshme urdhëroi prefekturën e Shkodrës që në kishën ortodokse të Shkodrës të aplikojë kalendari i ri kishtar dhe jo kalendari i vjetër që aplikonin kishat sllave. Zbatimi i kalendarit të ri duhej të bëhej në mënyrë të butë dhe të mos shkaktonte reaksion⁵⁴.

Mirëpo qeveria shqiptare, ashtu siç kishte vepruar shumë herë në rastin e veprimtarive nacionaliste në minoritetin grek, nuk u tregua e vendosur në zbatimin e masave të lartpërmendura ndëshkimore ndaj propagandistëve jugosllavë. Pasi kishin kaluar vetëm pak ditë, Këshilli i Ministrave vendosi për lirimin e këtyre të internuarve në Kurvelesh⁵⁵. Të sapokthyerit nga internimi bojkotuan menjëherë festën e krishtlindjeve dhe deklaruan se nuk i bindeshin KOASH. Prefektura e Shkodrës kishte të dhëna të sigurta se konsullata jugosllave nuk linte rast pa përdorur, për të inkurajuar kundërshtimin ndaj KOASH. Ajo kishte shpërndarë të holla, duke inkurajuar banorët e Vrakës që të rezistonin dhe, nëse do të internoheshin burrat, u kishte siguruar përkrahjen financiare familjeve të

⁴⁹ *Po aty*, fl. 164. Prefektura e Shkodrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 30 nëntor 1929.

⁵⁰ *Po aty*.

⁵¹ *Po aty*, fl. 174. Prefektura e Shkodrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 7 dhjetor 1929.

⁵² *Po aty*, fl. 83.

⁵³ *Po aty*, fl. 191. Prefektura e Shkodrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 16 dhjetor 1929.

⁵⁴ *Po aty*, F. MPB, V. 1929, D. 119/a, fl. 298. MPB drejtuar prefekturës së Shkodrës, 14 dhjetor 1929.

⁵⁵ *Po aty*, F. MPB, V. 1929, D. 18, fl. 200. Vendim i Këshillit të Ministrave, nr. 1204, dt. 22 dhjetor 1929.

tyre, ashtu siç kishte përkrahur edhe familjet e atyre vrakaçorëve që ishin internuar disa ditë më parë në Kurvelesh⁵⁶.

Më 23 dhjetor, ministri jugosllav Nastasioviç vizitoi Mitropolinë e Durrësit. Ai kërcënoi se Kryesia dhe kryetari i Sinodit të KOASH do të pendoheshin në qoftë se, brenda dy muajve, nuk do të kthehej situata e mëparshme kishtare në Vrakë. Mirëpo Kryesia e KOASH i rezistoi këtij presioni dhe deklaroi se ajo e kishte marrë parasysh çdo rrezik. Ministri jugosllav shtoi se së shpejti do të vinte Krisanthi me një episkop tjetër nga Greqia ndërkohë që Vasil Avrami ishte nisur përsëri në Greqi me mision.⁵⁷ Përmes kësaj mënyre të shprehuri, diplomati jugosllav paralajmëronte se në debatin shqiptaro-grek për KOASH, Jugosllavia do të mbështeste kauzën greke.

Megjithatë, gjatë krishtilindjeve të vitit 1929, gjendja në Vrakë u qetësua disi. Prefekti i Shkodrës shkoi bashkë me priftin e ri në Vrakë dhe në meshën e tij mori pjesë i gjithë fshati. Paria e fshatit i priti mysafirët me gosti dhe prematuan se do të respektonin plotësisht urdhrat fetare të Mitropolisë dhe të KOASH⁵⁸.

Në ditët e fundit të dhjetorit, konsulli jugosllav në Korçë, Koich, vizitoi prefektin e qytetit. Ky i fundit i shprehu keqardhjen se Patrikana Serbe, e cila fillimisht i kishte dhënë përkrahje krijimit të Sinodit ortodoks shqiptar, ishte tërhequr nga ky qëndrim dhe nuk pranonte të njihje zyrtarisht KOASH, ashtu siç kishte premtuar. Konsulli jugosllav u shpreh se ky reagim kishte ardhur si rezultat i qëndrimit të qeverisë shqiptare, e cila i kishte premtuar përfaqësuesit jugosllav në Tiranë, Mihajlloviç, se do ta njihje Viktorin si episkop të Shkodrës dhe si anëtar të Sinodit dhe se do të ruante *status quo*-në ortodokse në Shkodër dhe në rrethina. Ndërsa, në mbledhjen e Kongresit Panortodoks të Korçës dhe në Statutin e KOASH, të gjitha këto premtime ishin hedhur poshtë. Ai pohoi se, prej mosplotësimit të këtyre premtimeve, qeveria jugosllave tërhoqi ministrin e saj Mihajlloviç nga Tirana, i cili ishte zhgënjyer nga

⁵⁶ *Po aty*, fl. 221. Prefektura e Shkodrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 27 dhjetor 1929.

⁵⁷ *Po aty*, fl. 227. Prefektura e Durrësit drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 23 dhjetor 1929.

⁵⁸ *AQSH*, F. MPB, V. 1929, D. 18, fl. 223, Prefektura e Shkodrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 29 dhjetor 1929.

premtimet e thata që i ishin bërë⁵⁹. Prefekti i Korçës mohoi që qeveria shqiptare të kishte bërë premtime të tilla, pasi popullsia ortodokse e prefekturës së Shkodrës, e cila nuk i kalonte të 3900 personat, në pjesën më të madhe, ishte shqiptare. Vetëm një pjesë fare e vogël, jo më shumë se 500 vetë, ishte me origjinë sllave të cilët ishin shtetas të mirë shqiptarë dhe e dinin shumë mirë gjuhën shqipe⁶⁰.

Funksionimi i kishës ortodokse në Vrakë vijonte të kishte probleme. Në fillim të vitit 1930 dy të vdekur nga katundi Vrakë u varrosën pa shërbesat fetare, sepse një pjesë e vrakaçorëve filluan të kundërshtonin përsëri përfaqësuesin e Kishës Autoqefale Shqiptare. Ministria e Brendshme i kërkoi prefekturës së Shkodrës që ky veprim të ndalohej me masa administrative pasi, nëse do të tolerohej prania e mëtejshme e klerikëve serbë, do të çelte rishtazi plagën e privilegjeve që kishin pasur kishat e huaja të cilat ishin hequr kohët e fundit⁶¹. Nga ana tjetër, Ministria e Brendshme i kërkoi Ministrisë së Drejtësisë që të udhëzonte kryetarin e KOASH të emëronte në Vrakë një prift që dinte gjuhën sllave⁶². Ndërsa, prefektura e Shkodrës i dha urdhër komunës së Vrakës që të mos lejonte më varrosjen e të vdekurve pa u kryer shërbimet fetare. Në rast se do të përsëriteshin veprime të tilla, shkaktarët do të internoheshin, duke u konsideruar turbullues të qetësisë dhe propagandistë kundër interesave të shtetit⁶³. Mirëpo, dy muaj më vonë u përsërit një rast tjetër varrimi pa kryer shërbimet fetare. Famullitari i mëparshëm i Vrakës, pop Velisha nxiste banorët vendas që të kundërshtonin KOASH, duke premtuar se do të rivendosej gjuha sllave dhe do të aplikohet kalendari i vjetër⁶⁴.

Në korrik të vitit 1930, kryesia e KOASH kërkoi që të lejohej pop Velisha të kryente ceremonitë fetare në Vrakë, pasi ai e kishte plotësuar dënimin prej tetë muajsh për të mos meshuar⁶⁵. Edhe në vitin 1931, pop

⁵⁹ *Po aty*, F. MPB, V. 1929, D. 119/1a, fl. 304-308. Prefektura e Korçës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 24 dhjetor 1929.

⁶⁰ *Po aty*.

⁶¹ *Po aty*, F. MPB, V. 1930, D. 185, fl. 2. MPB drejtuar prefekturës së Shkodrës, 20 mars 1930.

⁶² *Po aty*, fl. 4. Ministria e Punëve të Brendshme drejtuar Ministrisë së Drejtësisë.

⁶³ *Po aty*, fl. 6. Prefektura e Shkodrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 28 mars 1930.

⁶⁴ *Po aty*, fl. 9. Prefektura e Shkodrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 17 maj 1930.

⁶⁵ *Po aty*, fl. 13. Kryesia e KOASH drejtuar Ministrisë së Drejtësisë, 18 korrik 1930.

Velisha vijoi të zhvillonte ceremonitë fetare në kishën e Vrakës në gjuhën sllave dhe sipas kalendarit të vjetër⁶⁶, gjë që ishte në kundërshtim me statutin e KOASH. Jugosllavët nuk ishin të kënaqur me lëshimet që kishte bërë KOASH dhe qeveria shqiptare në Vrakë por përpiqeshin që ta sfidonin autoritetin e saj në Shkodër dhe të sllavizonin edhe kishën ortodokse të atij qyteti.

Me kalimin e kohës, Kisha Autoqefale Shqiptare erdhi duke u forcuar por influencat e huaja ishin prezente, të gatshme për të goditur veprën e saj. Në vitin 1934, Risto Pleoneshi dhe Risto Gjergjo, kujdestarë të Kishës Autoqefale Ortodokse Shqiptare të qytetit të Shkodrës, po përpiqeshin të sillnin si famullitar në këtë kishë pop Velishën nga Vraça. Për këtë qëllim, ata kishin përgatitur një lutje dhe po mbledhnin nënshkrimet e banorëve ortodoksë të Shkodrës. Ata vepronin sipas udhëzimeve të konsullatës jugosllave e cila punonte për vendosjen nën kontroll të kishës së Shkodrës me anë të agjentit besnik të saj, pop Velishës. Ky kishte luftuar dhe vazhdonte të luftonte me vendosmëri autoritetin e KOASH në kishën e Shkodrës që realizohej nga famullitari i saj, i cili vepronte në përputhje me urdhrat dhe parimet e autoriteteve të larta kishtare shqiptare⁶⁷.

Teksa zbatonte reformën agrare kolonizuese në Kosovë, qeveria jugosllave u përpoq të përforconte pozitën ekonomike dhe pronësore të pakicës së Vrakës, pjesëtarët e së cilës ishin bujq pa tokë. Konsullata jugosllave ndërmjetësoi që banorët e Vrakës të blinin tokat e Sylçe Bej Bushatit. Prefektura i kërkoi Ministrisë së Brendshme që të frenoheshin një herë e mirë përpjekjet e vrakaçorëve ashtu dhe ndërhyrjet e konsullit jugosllav në këtë çështje⁶⁸. Përpjekjet e jugosllavëve për të forcuar dhe zgjeruar influencën e tyre në zonën e Shkodrës ndeshën në vështirësi. Kështu, qysh prej dhjetorit të vitit 1933 e deri në pranverë të vitit 1935 pati largime të banorëve të Vrakës për në Jugosllavi, me synimin që të instaloheshin atje përgjithmonë. Nga 175 familje me 1290 persona që kishin qenë në dhjetor të vitit 1933, kishin mbetur 60 familje me 367

⁶⁶ *AQSH*, F. MPB, V. 1931, D. 193, fl. 35. Komanda e qarkut Shkodër drejtuar Komandës së Përgjithshme të Xhandarmërisë, 3 shtator 1931.

⁶⁷ *Po aty*, F. MPB, V. 1934, D. 164, fl. 95. Komanda e xhandarmërisë së qarkut Shkodër drejtuar prefekturës së Shkodrës, 4 gusht 1934.

⁶⁸ *Po aty*, F. MPB, V. 1929, D. 18/ 1, fl. 261. Prefektura Shkodër drejtuar MPB, 9 nëntor 1929.

vetë, pra ishin shpërngulur 115 familje me 923 vetë⁶⁹. Këto shpërngulje ishin nxitur nga shkaqe ekonomike pasi banorët e Vrakës ishin joshur se do të gjenin një jetesë më të mirë në Jugosllavi. Qeveria dhe autoritetet shqiptare nuk ndërhyjnë në këtë proces. Pas disa kohësh, një pjesë e tyre do të kthehej sërish dhe shteti shqiptar i ripranoi ata, duke mos u nxjerrë asnjë pengesë. Kjo politikë ishte diametralisht e kundërt me politikat serbe dhe greke ndaj minoriteteve të cilët nuk lejonin kurrsesi që raste të tilla t'u iknin nga dora për të larguar pakicat nga territori shtetëror i tyre.

Romët në Shqipëri

Romët, “gabelët”*, ciganët, arixhinjtë apo jevgjit janë një pakicë kulturore me tipare të dallueshme në Shqipëri. Kjo popullsi ndahet në shtresëzime dhe grupe të ndryshme sociale e kulturore por, si në zhargonin popullor ashtu dhe në dokumentet shtetërore të asaj kohe, ka një paqartësi dhe pasaktësi të dukshme në emërtimin e saj.

Fatkeqësisht në arkivat shqiptare ka pak të dhëna rreth prezencës dhe trajtimit të tyre nga shteti shqiptar. Kështu, megjithëse jetesa e tyre në Shqipëri ka qenë shumë e gjallë dhe interesante, fatkeqësisht, në këtë studim nuk jemi në gjendje të trajtojmë në mënyrë të plotë historinë dhe problematikën e tyre. Sidoqoftë, nuk mund të lemë pa parashtruar disa nga të dhënat e zbuluara në arkiva, të cilat mendojmë se, gjithsesi, paraqesin një farë interesi për lexuesin.

Nga burimet arkivore rezulton se në vitet 1920 në prefekturën e Korçës u shtua shumë fluksi i ardhjes së arixhinjve. Një pjesë e tyre kishin ardhur nga Azia e Vogël gjatë fluksit të emigrimit të ortodoksëve të këtij rajoni, të cilët u instaluan nga qeveria greke rreth kufirit shqiptar. Në fund të viteve '20 numri i të papunëve nga ky komunitet u shtua. Ata siguronin jetesën duke dërguar gratë nëpër fshatra për të lypur si dhe duke u marrë me tregti kuajsh. Disa prej tyre bënë edhe vjedhje të vogla nëpër katunde. Përveç kësaj, disa nga gratë dhe të rejat e tyre, kur dilnin fshatrave, prostituonin. Autoritetet e Korçës ishin të shqetësuar nga fakti se këta nomadë, duke pasur lidhje me ortodoksët që ishin vendosur në kufirin shqiptaro-grek, mund të bëheshin çerdhe e ligësive të ndryshme.

⁶⁹ *Po aty*, F. MPB, V. 1935, D. 554, fl. 1-3. Prefektura e Shkodrës drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, 20 prill 1935.

* Kështu quhen në dokumentacionin e kohës.

Prandaj ato kërkuan shpërndarjen e tyre në prefektura të tjera⁷⁰. Por, Ministria e Brendshme nuk e quajti të dobishme shpërndarjen e tyre brenda territorit shqiptar. Ajo dha udhëzime për dëbimin e tyre me mjeshtëri administrative jashtë kufirit dhe për ndalimin e të tjerëve të hynin brenda kufirit shqiptar⁷¹.

Në vitet 1920-30, Shqipëria vijoi të përballej me fenomenin e imigrimit të ciganëve nga Lindja. Në prefekturën e Bilishtit në vitin 1929 erdhën 38 “gabelë” me nënshtetësi turke, në prefekturën e Vlorës erdhën 59 gabelë nga Izmiri, në Pojan të Korçës në vitet 1923-1924 kishin ardhur 76 gabelë nga Follorina e Greqisë. Në prefekturën e Gjirokastrës gjatë viteve 1923-1926 kishin ardhur 22 gabelë nga Greqia. Ata pretendonin se kishin nënshtetësi greke por u ishin grisur dokumentet nga autoritetet greke. Në prefekturën e Elbasanit kishte 14 arixhinj të ardhur nga Follorina⁷². Ministria e Brendshme pohonte se popullsia shqiptare ishte duke u dëmtuar moralisht e materialisht nga këta emigrantë, sepse ata nuk kishin ndonjë mjeshtëri për të siguruar jetesën e tyre në mënyrë të ndershme⁷³. Prandaj ajo dha urdhër për ndalimin e hyrjes së romëve në Shqipëri, me qëllim që të eliminoheshin pasojat negative. Ministria e Jashtme udhëzoi përfaqësitë shqiptare jashtë vendit që, në asnjë mënyrë, të mos u akordonin viza këtyre elementëve⁷⁴. Por, disa muaj më vonë ky qëndrim u zbut dhe u lejua dhënia e vizave vetëm atyre romëve që kishin familjet e tyre të instaluar prej kohësh në Shqipëri dhe atyre që shkonin nga Shqipëria në Greqi ose gjetkë për punë krahu, siç ishin disa romë nga Bilishti⁷⁵.

Disa të dhëna mbi hebrenjtë në shtetin shqiptar

Historia e hebrenjve në shtetin shqiptar është nga më mbresëlënëset. Ndonëse ishin një grup i vogël, ata ndërtuan marrëdhënie shumë të

⁷⁰ *Po aty*, F. MPB, V. 1928, D. 283, fl. 2. Nënprefektura Bilisht drejtuar prefekturës Korçë, 2 maj 1928.

⁷¹ *Po aty*, fl. 5. Ministria e Punëve të Brendshme drejtuar prefekturës Korçë, 16 maj 1928.

⁷² *AQSH*, F. MPB, V. 1929, D. 271, fl. 2. Qarkore e MPB dërguar prefekturave, 15 korrik 1929.

⁷³ *Po aty*.

⁷⁴ *AMPJ*, V. 1929, D. 948, fl. 1. Qarkore e Ministrisë së Punëve të Jashtme, 23 korrik 1929.

⁷⁵ *Po aty*.

ngushta me popullsinë shqiptare të cilat kanë mbetur të pashlyera në kujtesën e të dy palëve. Lidhur me këtë temë ka patur disa studime interesante nga autorë shqiptarë dhe të huaj, prandaj në këtë artikull po japim vetëm disa të dhëna të tjera mbi prezencën e hebrenjve në Shqipëri gjatë periudhës së republikës dhe monarkisë.

Pas shpalljes së shtetit të pavarur shqiptar, ndryshe nga vendet e tjera ballkanike, pozita e hebrenjve do të mbetej ashtu siç kishte qenë në periudhën osmane. Sipas botimeve të hebrenjve amerikanë, shqiptarët ishin të parët dhe, ndoshta të vetmit, që pranuan rezolutën e Dr. Gaster për njohjen e të drejtave të hebrenjve në Ballkan.⁷⁶ Shqipëria do të fillonte mëkëmbjen e saj si shtet i pavarur vetëm pas vitit 1920. Në këtë kohë, si rezultat i luftës, numri i hebrenjve ishte i vogël dhe arrinte në rreth 100 vetë. Por më vonë numri i tyre do të vinte duke u rritur.

Në raport me disa vende të tjera ballkanike, shqiptarët kanë mbajtur një qëndrim pozitiv specifik ndaj hebrenjve. Në Shqipëri ata u respektuan, u strehuan dhe u mbrojtën, gjë që nuk ndodhi në vendet e tjera. Veçanërisht në Rumani, Greqi e Serbi, forcat ultranacionaliste dhe profashiste mbajtën një qëndrim armiqësor të hapur kundrejt hebrenjve. Ndërsa në Shqipëri nuk u konstatuan shfaqje të tilla.

Midis hebrenjve dhe shqiptarëve në këtë kohë ekzistonte një ndjesi e përbashkët, pasi ata ishin viktimat e nacionalizmave serb dhe grek. Në vitet 1920-1930 hebrenjtë, ashtu si dhe shqiptarët, u panë me armiqësi dhe përçmim nga qarqet politike të Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene. Shquhet një shkrim i Vladan Gjorgjeviç, ish Kryeministër i Serbisë, i cili theksonte se shqiptarët mund të krahasoheshin me hebrenjtë të cilët, deri vonë, “kishin pasur bishta si majmunët”.⁷⁷ Në Jugosllavi, pas një përmirësimi të përkohshëm të pozitës së hebrenjve në fillimin e viteve 1930, si rezultat i këmbënguljes së shoqërive të tyre, gjendja u keqësua sërish në vitin 1936, kur qeveria jugosllave vendosi të pengonte lëvizjen e lirë të banorëve jo serbë të Kosovës.⁷⁸

Edhe vende të tjera ballkanike janë shquar për një trajtim armiqësor të hebrenjve. Më poshtë po japim një panoramë të shkurtër me qëllim që lexuesi të ketë mundësi të bëjë dallimet midis Shqipërisë dhe vendeve të

⁷⁶ Haxhi Bajraktari, *Marrëdhëniet shqiptaro-hebraike*, Instituti Shqiptar i Studimeve Politike-Tiranë, Prishtinë, 2009, f. 87. Autori i referohet “The American Jewish Year Book 5674”, i botuar prej Herbert Friedenwald dhe G. H. Friedman.

⁷⁷ Noel Malcolm, *KOSOVA, një histori e shkurtër*, Prishtinë: Koha, 1998, f. 280.

⁷⁸ H. Bajraktari, *Marrëdhëniet shqiptaro-hebraike...*, f. 90.

tjera të rajonit në lidhje me trajtimin e hebrenjve në një nga periudhat më të vështira të historisë së ekzistencës së tyre.

Një histori rrëqethëse përbën persekutimi i hebrenjve në Rumani. Kështu, qysh në vitin 1923 në rrethet studentore në Bukuresht, u krijua një Fasho sipas modelit musolinian. Po atë vit, profesor Aleksandër Kuza (Cuza) (1857-1947) i Universitetit të Jashit, themeloi “Lidhjen e Mbrotjtjes Kombëtare Kristiane”, në të cilën aderorin shumë nacionalistë antisemitë, të cilët bashkoheshin me “fshatarizmin” (taranizmul), që kishte pasur ndikim edhe në rrethin e I. Muhalakes. Në zgjedhjet e vitit 1926, ajo mori 10 vende në parlament. Pastaj u bashkua me poetin transilvan Oktavian Goga, gjë që i lejoi këtij të fundit të bëhej më 1937 kryeministër për pak kohë dhe të praktikonte një antisemitizëm brutal e shkatërrimtar. Me rrënjët në të njëjtën tokë por me struktura edhe më fashiste, ishte lëvizja e “Gardës së Hekurt” (Garda de Fier) e Korneliu Kodreanu (1889-1938). Ai kreu një sërë veprimesh të dhunshme kundër çifutëve. Më 1927 ai e ristrukturoi lëvizjen e tij sipas modelit nazist. Këto ishin “këmishat e gjelbërta”. Rojet e hekurta filluan sërish bëmat e tyre kundër çifutëve të Besarabisë, ku më 1932 Kodreanu u zgjodh deputet⁷⁹.

Në luftën që filloi më 22 qershor 1941 midis Hitlerit dhe Stalinit, rumunët u gjetën në rreshtin e parë. “Shteti legjendar” i shtatorit 1940 nuk pati jetë të gjatë. Teprimet e gardistëve e shqetësuan konduktorin por edhe komandën gjermane e cila donte që bazat e saj në prapavijat e frontit të ardhshëm lindor të ishin sa më të qëndrueshme. Më 21 janar 1941, gardistët shtinë në dorë Bukureshtin, duke masakruar me tmerre 350 personalitete, midis tyre shumë çifutë. Të nesërmen, Antonesku lëshoi oficerë e ushtarë rumunë, të mbështetur nga pancerët e Vermahtit, në një gjueti të pamëshirshme kundër legjioneve.⁸⁰ Nën presionin nazist, Antonesku futi në Rumani një legjislacion antisemit, i cili përcaktonte përjashtimin e çifutëve nga profesionet e mjekut, avokatit, gazetarit; ndalimin për të pasur aparate radioje, automjete, të frekuentonin kinematë etj. Megjithatë, këtu çifutët nuk njohën as getot dhe as deportimet masive në kampet e shfarosjes së Rajhut.⁸¹

⁷⁹ Georges Castellan, *Histori e Ballkanit (shek. XIV-XX)*, Tiranë: Çabej, 1996, f. 441-442.

⁸⁰ *Po aty*, f. 446.

⁸¹ *Po aty*, f. 468.

Në Greqi 45.000 çifutë sefardi të Selanikut u deportuan në kampet e shfarosjes në Birkenhau dhe Bergen-Belsen.⁸² Nacionalizmi grek e demonstroi urrejtjen ndaj hebrenjve duke i dorëzuar te gjermanët dhe duke ndihmuar në deportimin e hebrenjve.

Një fenomen kontradiktor ndodhi në Bullgari në vitet '40. Kryetari i qeverisë bullgare B. Fillovi ishte i frymëzuar nga modeli nazist dhe kishte nxitur vendosjen në fuqi të një legjislacioni antisemit. Një ligj "Për ruajtjen e kombit" (dhjetor 1940) vendoste mbajtjen e yllit të verdhë dhe parashikonte dëbimin e izraelitëve nga Sofja. Por, kur Hitleri kërkoi deportimin e tyre në Rajhun gjerman, qeveria e Fillovit, nga frika e opinionit publik, u kufizua vetëm me arrestimin e çifutëve të territoreve të pushtuara të Jugosllavisë dhe Greqisë (rreth 10 000 vetë), kurse ata të Bullgarisë u mbrojtën nga Asambleja : 43 deputetë pro qeveritarë, midis tyre edhe nënkryetari i Parlamentit, protestuan dhe qeveria u tërhoq. Çifutët e Bullgarisë qenë ndër ata komunitete të pakta me fat në Evropën e sunduar nga nazizmi që nuk u deportuan në kampet e shfarosjes në masë.⁸³

Në Shqipëri nuk pati asnjëherë një lëvizje antisemite. Qysh në vitet '20, pas Luftës Greko-Turke shumë hebrenj u detyruan të emigronin nga Janina në Shqipëri për t'i shpëtuar përndjekjeve greke. Të dhënat e kohës dëshmojnë se komuniteti hebraik ka pasur një jetë të qetë në shtetin e ri shqiptar. Pjesëtarët e tij ishin të lirë të ushtronin praktikat e tyre fetare dhe të merrnin pjesë në jetën ekonomike e institucionale të vendit, pa asnjë dallim dhe kufizim. Diplomati amerikan në Shqipëri, Herman Bernstein shkruante në vitin 1934 se "në Shqipëri nuk ka pasur probleme për çifutët. Në këtë vend të vogël të bukur të Adriatikut nuk ka shenja të diskriminimit të tyre, jo thjesht se komuniteti çifut është i vogël në numër por sepse Shqipëria sot është një nga vendet e rralla në Evropë, ku paragjykimet fetare dhe urrejtja racore nuk ekzistojnë, megjithëse shqiptarët janë ndarë në tre besime".⁸⁴

Edhe studiuesi Myrteza Studenica pohonte se "ndër shqiptarët, qoftë në Shqipëri, qoftë jashtë kufijve shtetëror të saj, si dhe në diasporën shqiptare nuk ka pasur dhe nuk ka antisemitizëm. Paragjykimet fetare kurrë nuk u shndërruan në urrejtje historike kundër hebrenjve ... Që nga

⁸² *Po aty*, f. 481.

⁸³ *Po aty*, f. 471, 472.

⁸⁴ Apostol Kotani, *Hebrenjtë në Shqipëri gjatë shekujve*, Dituria, Tiranë 1996, f. 39.

koha e pushtimeve romake, kur hebrenjtë qenë shpërngulur nga trojet e tyre në Iliri, e deri në ditët tona nuk është shënuar ndonjë vrasje e hebrenjve”.⁸⁵

Në vitet '20-'30, Shqipëria ishte një parajsë për hebrenjtë të cilët përpiqeshin të shpëtonin nga kthetrat e nazistëve. Ishin me mijëra ata që mundën të merrnin viza për të kaluar në Shqipëri ose edhe për të qëndruar sipas dëshirës. Në vitin 1928, Kushtetuta e Shqipërisë përcaktonte nderimin dhe respektin për të gjitha llojet e besimit. Kjo përcaktoi që besimi dhe identiteti i hebrenjve të respektoheshin.

Megjithëkëtë duhet pohuar se në ndonjë ligj dhe rregullore u shfaqën disa kufizime për të drejtat e hebrenjve. Por qeveria shqiptare nuk pati dëshirën dhe vullnetin për t'i zbatuar ato. Dukej qartë që këto parashikime ligjore dhe administrative ishin bërë nën presionin e italianëve. Praktikisht, ndaj hebrenjve nuk u ushtrua asnjë kufizim i veçantë. Qeveria shqiptare dha edhe një ndihmë modeste për refugjatët hebrenj në nevojë.

Qëndrimi dashamirës i qeverisë shqiptare për hebrenjtë filloi t'i shqetësonte italianët të cilët synonin kolonizimin e Shqipërisë. Ata arritën të ushtronin presion dhe të pengonin ecjen e shpejtë të projekteve për instalimin e hebrenjve në Shqipëri, siç ishte ai i Cleveland Tractor Company.⁸⁶ Italianët u treguan shumë vigjilentë për të gjitha lëvizjet që po bëheshin në këtë drejtim, duke vënë në survejim edhe ata persona apo zyrtarë shqiptarë e të huaj që po mbështesnin këto projekte. Në raportet diplomatike italiane pohohej se “hebrenjtë në Shqipëri gëzojnë një simpati të madhe nga shqiptarët, në përgjithësi, dhe, në veçanti, nga qarqet qeveritare, duke përfshirë edhe ambientet e shtëpisë mbretërore.”⁸⁷

Organizimi i lëvizjes sioniste në Shqipëri mori një përkrahje shtetërore kur, në janar të vitit 1937, qeveria shqiptare autorizoi që të krijohet Komiteti Themeltar Kombëtar Hebraik i kryesuar nga Menachem Yonitov dhe Isaac Cohen. Tre muaj më vonë, shteti njohu zyrtarisht komunitetin hebraik në vend.⁸⁸

Klima tolerante dhe qëndrimi dashamirës i shqiptarëve ndaj komunitetit hebraik dhe rreziku që përbënte për ta ardhja e Hitlerit në

⁸⁵ *Rilindja*, Zvicër, 30 mars 1993.

⁸⁶ H. Bajraktari, *Marrëdhëniet shqiptaro-hebraike ...*, f. 102. Autori i referohet USNA, State Department Records (RG59), Decimal File, 1910-1949: 8756112/11.

⁸⁷ *Po aty*, f. 103. Autori i referohet *AQSH*, F. 163, V. 1938, D. 158, fl. 32.

⁸⁸ *Po aty*, f. 94.

fuqi në Gjermani, e shtyu ambasadorin amerikan në Tiranë, Herman Bernstein të fillonte përpjekjet për vendosjen e hebrenjve në Shqipëri. Ai pa mundësi reale për realizimin e këtij projekti të cilin e vlerësonte se ishte si në dobi të hebrenjve ashtu edhe të shqiptarëve të cilët do të përfitonin kapitale të mëdha për zhvillimin e vendit të tyre. Qeveria shqiptare mirëpriti propozimet e Bernsteinit, kërkesat e Komisarit të Lartë për Refugjatët të Lidhjes së Kombeve, James McDonald, si dhe projektin e kompanisë së fuqishme amerikane, Cleveland Tractor Company për tharjen e disa kënetave, me qëllim që në to të instaloheshin hebrenjtë. Ajo pranoi të jepte një sipërfaqe prej 220.000 hektarësh për këtë qëllim.⁸⁹ Përveç aspektit human, qeveria shqiptare po tregonte shumë interes për investimet e kapitalit hebre në vend.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Brendshme, në vitin 1937 çifutët në Shqipëri ishin shpërndarë si më poshtë:⁹⁰

Në Gjirokastrë	12 familje	me 51 vetë
Në Tiranë	13 familje	me 13 vetë
Në Durrës	7 familje	me 21 vetë
Në Vlorë	16 familje	me 17 vetë
Në Shkodër	2 familje	me 11 vetë
Në Korçë	3 familje	me 3 vetë

Gjatë viteve 1938-1939, popullsia hebraike në Shqipëri u rrit në mënyrë të ndjeshme. Konsujt shqiptarë, në bazë të orientimeve të qeverisë së tyre, u treguan shumë tolerantë dhe dhanë viza të shumta hyrjeje. Ndërsa autoritetet zyrtare në Shqipëri u dhanë shtetësinë shqiptare shumë hebrenjve të ardhur, gjë që nuk ndodhte në vendet e tjera. Përveç shifrës zyrtare prej 350 hebrenjsh, kishte shumë të tjerë në vend, shumica e të cilëve ishin me viza “turistike” ose “transiti” të skaduara.

Personalitetet e shquara shqiptare Fan Noli, Gjergj Fishta e të tjerë dolën hapur në mbrojtje të albanologut të njohur Norbert Jokl dhe bënë përpjekje për ta tërhequr atë nga Austria, e cila ndodhej nën kontrollin e gjermanëve. Ata arritën që të nxisnin edhe Viktor Emanuelin dhe Kontin Çiano i cili ndërhyri, megjithëse pa sukses, tek homologu i tij gjerman për ta lejuar Joklin të largohej nga Austria. Jokli u arrestua dhe u zhduk

⁸⁹ *Po aty*, f. 98-99.

⁹⁰ *AQSH*, F. MPB, V. 1937, D. 109. Të dhëna për çifutët në Shqipëri.

nga gjermanët në vitin 1942. Fatin tragjik të tij e kishte pasur edhe albanologu tjetër i madh hebre, Milan Shufflay, i cili u vra barbarisht nga policia sekrete jugosllave me 19 shkurt të vitit 1931 para derës së shtëpisë së tij, pikërisht për arsye të kontributit të shquar që kishte dhënë e po jepte për shkrimin e historisë së shqiptarëve.⁹¹ Këto personalitete të shquara mbeten të nderuara e të vlerësuara nga kombi shqiptar dhe një simbol i përvetshëm i miqësisë shqiptaro-hebraike.

Në fillim të Luftës së Dytë Botërore situata në Shqipëri dukej kaq mirë për hebrenjtë shqiptarë, sa që ata ndjeheshin të sigurtë dhe pak vëmendje u ishte kushtuar fjalëve të emigrantëve që vinin në Shqipëri rreth tmerreve në rritje në vendet e Evropës Qendrore.

Forcat e lëvizjes nacionalçlirimtare në Shqipëri kultivuan vazhdimisht një ndjenjë solidariteti dhe humanizmi për hebrenjtë dhe i mbrojtën me vendosmëri ata. Rastet dhe dokumentet janë të shumta. Në këtë drejtim ata kishin mjaft ngjashmëri me lëvizjet e tjera çlirimtare në Ballkan që drejtoheshin nga forcat e majta.

Por veçori për Shqipërinë përbën fakti se edhe formacionet dhe forcat nacionaliste u vunë në mbrojtje të hebrenjve. Studiuesi i njohur i hebrenjve në Shqipëri, Apostol Kotani ka vërtetuar se as ballistët, as zogistët, por as milicët dhe xhandarët që ishin nën komandën e qeverive që vepronin nën kontrollin e italianëve dhe gjermanëve nuk i denoncuan e dorëzuan hebrenjtë, por i mbrojtën ata.⁹² Kështu, Kryeministri kuisling Mustafa Kruja i kërkoi me këmbëngulje Mëkëmbësit të Përgjithshëm të Italisë në Shqipëri, Jacomonit që të bëhej ç' ishte e mundur për të shpëtuar izraelitët e Kosovës të cilët ishin grumbulluar në Prishtinë në pritje për t'iu dorëzuar autoriteteve naziste. Jacomoni e miratoi kërkesën e tij dhe u bënë veprimet për largimin e izraelitëve nga Prishtina dhe për sjelljen e tyre në Shqipëri.⁹³ Po kështu, vlen të përmendet ndihma e ish-sekretarit të bashkisë së Prishtinës, Preng Uli, për pajisjen me letërnjoftime të rreme të shumë hebrenjve.⁹⁴

Kombi shqiptar, jo vetëm që mbrojtë hebrenjtë që gjendeshin në territorin e tij, por nuk lejoi asnjë hebre tjetër i cili, fatmirësisht, kishte mbërritur në këtë vend, të dorëzohej te nazistët. Kur nazistët kërkuan

⁹¹ H. Bajraktari, *Marrëdhëniet shqiptaro-hebraike ...*, f. 109-111.

⁹² A. Kotani, *Hebrenjtë në Shqipëri gjatë shekujve ...*, f. 81.

⁹³ Francesco Jacomoni, *La politica dell'Italia in Albania*, Padova: Capelli editore, 1965, f. 288, 289.

⁹⁴ A. Kotani, *Hebrenjtë në Shqipëri gjatë shekujve ...*, f. 57.

listat e hebrenjve në vitin 1943, qeveria shqiptare kundërshtoi t'i dorëzonte ata. Hebrenjtë në Shqipëri lëviznin sa në një qytet në tjetrin dhe më së shumti në Vlorë dhe Durrës. Shqiptarët, pa marrë parasysh rrezikun, i strehuan, i ushqyen ata dhe nuk i lejuan që të bëheshin viktima të Holokaustit.

Marrëveshja e regjencës shqiptare me gjermanët që këta të mos ndërhyjnë në punët e brendshme të Shqipërisë, ishte me rëndësi vendimtare për fatin e hebrenjve. Kur gjermanët i kërkuan regjencës t'u dorëzonte listat e tyre në tërë Shqipërinë, qeveria shqiptare kundërshtoi, duke iu referuar pikërisht kësaj marrëveshjeje. Madje edhe ministri i Brendshëm, Xhafer Deva, që cilësohej si antisemit, u vu në mbrojtje të hebrenjve. Harvey Sarnet⁹⁵ shkruan se “nacionalizmi i Ministrisë Deva e tejkalonte antisemitizmin e tij. Ai protestoi te gjermanët dhe arriti që t'i bindte ata të tërhiqnin kërkesën për hartimin e listave të hebrenjve”. Ai u pohoi atyre se e konsideronte këtë si një shkelje flagrante të marrëveshjes dhe si një ndërhyrje arbitrare në punët e brendshme të Shqipërisë.

Edhe Mbreti Zog I, i cili gjatë luftës ndodhej në mërgim në Britaninë e Madhe, u propozoi udhëheqësve britanikë një plan për vendosjen e 50 000 familjeve hebraike në Shqipëri. Ai e përshkroi Shqipërinë si një vend të pasur me burime natyrore por me një popullsi të varfër, i cili kishte mundësi që të mbante lehtësisht një popullsi 5 milionëshe. Ai premtoi që t'i jepte çdo familjeje hebraike një fermë në tokat që ishin pronë shtetërore, në bregdet.

Edhe në Kosovë gjermanët morën masa, ashtu si në vendet e tjera të pushtuara, për përndjekjen e hebrenjve. Por, çuditërisht, edhe këtu këto masa, në përgjithësi, dështuan dhe urdhrat e tyre nuk u zbatuan. Megjithatë, hebrenjtë këtu nuk qenë aq fatlumë sa ata në Shqipërinë politike. Numri i të mbijetuarve në Kosovë ishte 60%, shifër që e bën atë njërën prej zonave me përqindjen më të lartë të të mbijetuarve në Evropën e pushtuar.

Mbrojtja e hebrenjve nga forcat nacionaliste shqiptare është një dëshmi tjetër e profilit më human të këtij nacionalizmi. Në këtë drejtim, nacionalizmi shqiptar provoi se kishte dallime të rëndësishme me disa nga nacionalizmat e tjerë ballkanikë të cilët, në përgjithësi, u sollën në mënyrë johumane ndaj hebrenjve dhe pakicave të tjera në vendet e tyre.

⁹⁵ Harvey Sarnet, *Shpëtimi, historia e patreguar e fisnikëve shqiptar të cilët i shpëtuan hebrenjtë nga Holokausti*, Tiranë: Koha, 1998.

Një arsye mund të jetë fakti se shteti shqiptar dhe shtetet e tjera ballkanike u krijuan në rrethana të ndryshme historike dhe, gjithashtu, ndoqën rrugë të ndryshme të zhvillimit të tyre kombëtar. Karakteristikë themelore e shteteve ballkanike është se ato u krijuan dhe u konsoliduan si shtete homogjene dhe unitare nga pikëpamja fetare, gjë që ndikoi shumë në kultivimin e hipernacionalizmit dhe të ekskluzivitetit etnik. Ndërsa kombi e shteti shqiptar u zhvilluan si entitete që bazoheshin në tolerancën e bashkëpunimin e popullsisë etnike shqiptare të tre besimeve të ndryshme me një shumicë të spikatur myslimane, gjë që ka ndikuar mjaft në pranimin e bashkëjetesës në diversitet dhe në shmangien e fenomenit të ekskluzivizmit dhe hipernacionalizmit.

Mbështetjen e shqiptarëve e provonte qartë prirja e hebrenjve për t'u zhvendosur nga vendet e tjera evropiane drejt Shqipërisë. Ata e dinin se edhe në Shqipëri do të gjenin pushtuesit nazistë por ata e morën këtë vendim, duke shpresuar shumë në përkrahjen e popullit shqiptar, duke njohur mirë, me sa duket, kodin e hershëm të tij të besës dhe mbrojtjes së mikut.

Shqipëria përbën një rast të veçantë në Ballkan për mbrojtjen e hebrenjve. A ishte kjo një rastësi apo një fenomen i izoluar? Në qoftë se do të studionim me kujdes konstruktin socio-human dhe kulturor-shpirtëror të shqiptarëve, mund të tentonim të jepnim një shpjegim për këtë fenomen. Shpirti humanist i shqiptarëve ka rrënjë të thella në histori, ai është thelbi i kodit të tyre të jetesës, një kod i pandryshueshëm në shekuj që dominoi të gjitha strukturat sociale, shpirtërore e shtetërore të kombit shqiptar. Por, për të kuptuar sakrificat që bënë shqiptarët për mbrojtjen e hebrenjve gjatë Luftës së Dytë Botërore, duhet të nënvizojmë se ky nuk ishte i vetmi akt humanizmi dhe një fenomen i izoluar në historinë e tyre. Ata janë po kaq të shquar në rajon apo edhe në Evropë për mbrojtjen, respektimin dhe jetesën në harmoni me të gjitha pakicat kombëtare apo etno-kulturore gjatë gjithë kohërave. Ky virtyt i shqiptarëve ka ndikuar dukshëm në politikat pozitive të shtetit shqiptar ndaj minoriteteve gjatë gjithë jetës gati njëshekullore të tij. Askund në Ballkan minoritetet nuk mbijetuan siç ndodhi në Shqipëri.

Duke njohur këto cilësi pozitive të shqiptarëve, hebrenjtë nuk ishin i vetmi minoritet që kërkuan mbrojtje në Shqipëri. Por edhe dy minoritetet e tjera, si ai bullgar ose maqedon dhe ai vllah kërkuan të futeshin në përbërje të shtetit shqiptar për të siguruar jetesën dhe identitetin e tyre që u kanoseshin nga regjimet nacionaliste të Greqisë dhe Serbisë. Kështu,

popullsia maqedone e zonës së Prespës i kërkoi Konferencës së Ambasadorëve në vitin 1921 që të bashkohej me Shqipërinë dhe kjo zonë u bashkua me shtetin shqiptar në vitin 1924. Gjatë gjithë periudhës vijuese kjo popullsi e ruajti, pa asnjë problem, identitetin e saj.

Edhe vllhtë e Maqedonisë e të Pindit, dy herë me radhë, në vitin 1913 në Konferencën e Ambasadorëve në Londër dhe në vitin 1919-1920 në Konferencën e Paqes në Paris, kërkuan me këmbëngulje bashkimin me shtetin e ri shqiptar, të cilin e shihnin si më të mundshmin për të ruajtur identitetin, nderin dhe jetën e tyre.

Në të njëjtën kohë, toleranca e harmonia ndërfitare i shquan shqiptarët si një komb me resurse e strukturë të shëndoshë humane e civile.

S u m m a r y

THE MONTENEGRIN MINORITY, THE ROMA AND THE JEWS FROM 1925 TO 1939

The Montenegrin minority in Albania present an interesting case study due to the fact that a small ethnic group of 1500 inhabitants has managed to survive as a national minority and is recognized as such, preserving and developing its national and religious identity, receiving education in the mother tongue, etc. This paper deals with the attempts of the Montenegrin minority to preserve its identity and with the policies followed by the Albanian state from 1925-1939 with regards to this minority. In this context, are examined several questions, such as: the Albanian government's attitude concerning the activity of the Serbian Church serving in this minority; the attempts of the Serbian Church to increase its influence in the regions of Shkodra and Dibra, utilizing the presence of this minority and the historical legacy from the Ottoman period; in addition, are examined the attempts of the Serbian Church and government to influence the process towards the Autocephaly of the Albanian Orthodox Church, i.e. requests to establish a Serbian Archbishopric in Shkoder and representation with a bishop in the Synod (AAOCH) of the Albanian Autocephalous Orthodox Church.

The debate and contradictions that rose between the two countries in relation to these issues cover an important part of the paper.

Moreover, in the paper are examined the attempts of the Yugoslav government to retain a Serbian minority school in the town of Shkodra and the

views of the Albanian government opposing such attempts. Besides the above questions, our study provides evidence from the Albanian archives on the presence of the Roma ethno-cultural minority in Albania and its social status and problems and the way they were handled by the Albanian central and local governments. In this article we will deal also with the attitude of the Albanian government and people towards Jews. There are given statistical data on the size of this community, which at the time amounted to 300 individuals, and the respective policies followed by the Albanian government.

